


Përfitimi nga eficiency e energjisë nga sektori rezidencial

Punim Pozicionues



Përfitimi nga efienca e energjisë nga sektori rezidencial

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i Qëndrueshëm**

Publikimi: **Nëntor, 2020**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) mbështetur nga GIZ. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Shënim:

Ky punim është shkruar në gjuhën angleze fillimisht. Prandaj, për arsye teknike, disa nga pjesët e tij kanë mbetur në origjinal, të papërkthyer.

Përmbajtja

1. Hyrje	1
2. 10 milionët e parë	2
3. Analiza: Zbatimi i masave EE në sektorin e banimit	6
4. Materialet & Kostot	6
5. Ndikimi i politikës në sektorin e banimit	11
5.1. Efektet e tjera që politika e re do të kishte në të ardhurat tatimore	11
5.2. Fuqia punëtore dhe tatimi në të ardhura personale	12
6. Kursimet e energjisë	14
7. Përfundim	15
8. Rekomandimet	16

1. Hyrje

Javët e para të izolimit për shkak të pandemisë COVID-19 shënuan rënie në aktivitetet ekonomike të Kosovës, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) parashikon gjendje bazë me 5 përqind tkurrje të ekonomisë si pasojë e kësaj.¹ Megjithatë, e njëjta periudhë po ashtu shënoi indeks më të lartë të cilësisë së ajrit, ndërsa po ashtu veçoi si përkujtim i urgjencës së aktiviteteve për zbutjen e ndryshimeve klimatike, pavarësisht nga situata e pandemisë që po ndryshon shpejt². Ky dokument argumenton se përputhja midis dy ngjarjeve, si dhe një hap që mund të hidhet lehtësisht gjatë pandemisë, është të nxiten mundësitë dhe stimujt në efikasitet të energjisë (EE) për sektorin e banimit. Ky paraqet një analizë të kostove të përafërta të masave të EE, pasuar nga një propozim për mbështetje qeveritare përmes instrumenteve kombëtare të EE, si dhe rekomandimet për përshkallëzimin e iniciativës së tillë.

Përderisa caku i Komunitetit të Energjisë (KiE) për burimet e ripërtërishme është arritur për shkak të përdorimit të gjerë të druve të zjarrit në vend, Kosova ka ngecur në masë të madhe prapa në arritjen e caqeve të KiE-së për EE në vitin 2020. Rrjedhimisht, përfitimet e mëdha në kursime të energjisë janë ende mjaft të arritshme. Ekziston përkushtimi i nivelit të lartë të Kosovës për Programin e Reformës Ekonomike (PRE), për adresimin e rekomandimit për "Rritjen e stimujve të efikasitetit të energjisë për sektorin privat dhe atë të ekonomive familjare" të Konkluzioneve të Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar, si një nga faktorët kryesorë që pengojnë konkurrencën në vend.³ Përkushtimi i tillë përmes PRE-së ka ndikim afatgjatë përkundrejt mbështetjes që Kosova merr nga BE-ja, ndërsa zbatimi i rekomandimit për EE do të luante rol vendimtar në ndihmën e BE-së në vitet e ardhshme - në aspekte teknike, financiare, por edhe në nivel politik.

Duke parë buxhetin e vitit 2020, si dhe trysinë që pandemia COVID-19 ka ushtruar mbi procesin e rishikimit të buxhetit, ekziston një prirje e natyrshme për të kontraktuar investime publike në favor të transfereve sociale. Kjo mund të vërehet në planet e Qeverisë për të anuluar investimin nga Agjencia

¹ Fondi Monetar Ndërkombëtar, (2020), Njoftim për shtyp Nr. 20/149, gjendet tek <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/04/10/pr20149-kosovo-imf-executive-board-approves-us-million-emergency-support-address-covid-19-pandemic> (qasur në korrik të vitit 2020)

² Grupi i Bankës Botërore, (2020), Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor, Nr. 17: Ndikimi Ekonomik dhe Social i Covid-19, Pranverë, gjendet tek <http://documents1.worldbank.org/curated/en/562671590682452189/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Air-Pollution-Challenges.pdf> (qasur në korrik të vitit 2020)

³ Këshilli i Bashkimit Evropian, (2019), Konkluzione të Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, gjendet tek <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-9474-2019-INIT/en/pdf> (qasur në korrik të vitit 2020)

e Kosovës për Eficiencë të Energjisë në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren, si dhe planet për uljen e financimit vjetor për Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) me 25 përqind.⁴ Siç ndodh aktualisht në të gjithë botën, rënia e ekonomisë është e mprehtë, ndërsa planet, idetë dhe shumë propozime janë në vazhdim e sipër për të stimuluar sektorët e ekonomisë me pako stimuluese, ashtu që të përfitohet nga zinxhirët e furnizimit, si dhe të ristrukturohen ata. Kur analizohen rëniet, vëmendje e konsiderueshme i kushtohet madhësisë së ndikimit negativ, ndërsa kapja dhe shfrytëzimi i mundësisë që paraqitet si rezultat shumë herë anashkalohen.

Qëllimi i këtij dokumenti është të propozojë një politikë, përmes së cilës më shumë resurse publike alokohen tek transformimi i sektorit të energjisë, duke hyrë në sektorin e banimit. Këto masa do të stimulojnë sektorin e ndërtimitarisë, pasi ndryshe ndikimi ekonomik i pandemisë do ta godiste fort, me efekt të fortë në pjesën tjetër të ekonomisë. Ligji aktual për eficiencën e energjisë i mundëson FKEE-së të hartojë, së bashku me qeverinë, një mundësi të re financimi për sektorë të tjerë, përveç objekteve publike. Mundësia e tillë e re duhet të fillojë duke shfrytëzuar financimin nga shteti në sektorin e banimit.

2. 10 milionët e parë

Ashtu si në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2019, sektori banesor mbeti sektori me hisen më të madhe të konsumit të energjisë⁵, e për këtë, ai duhet të jetë subjekt i një skeme, ku shteti e financon drejtpërdrejt me grante për shkak të ndikimeve gjithëpërfshirëse që ka konsumi joefikas i energjisë në të gjithë sistemin. Në rrethanat aktuale, zgjidhja më e mirë për mbështetjen e sektorit privat do të ishte përmes një instrumenti të garantimit të kredive, shoqëruar me grante, ndërsa elaborimi i mëtejshëm i kësaj skeme do të duhej saktësuar në një projekt-dokument tjetër politike.

Qeveria kosovare duhet të përdorë nevojat e sektorit privat, duke shpallur masa me një pilot-projekt, me të cilin hyn guximshëm në investime në eficiencë të energjisë në sektorin amvisnor, me fonde publike prej 10 milionë eurosh, deri në fund të vitit 2021. Pavarësisht teknologjive e zbulimeve të reja, izolimi ndërtimor mbetet një nga faktorët më të rëndësishëm në rritjen e eficiencës së energjisë dhe performancës energjetike të objekteve. Me kosto relativisht të ulët, eficienca elementare e energjisë

⁴ Bordi i Drejtorëve të FKEE-së, (2020), Intervistë Personale

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2020), Bilanci vjetor i energjisë në Republikën e Kosovës 2019, Prishtinë: ASK, gjendet tek <https://ask.rks-gov.net/media/5481/balanca-e-energjis%C3%AB-2019.pdf> (qasur në korrik të vitit 2020)

arrihet përmes izolimit të jashtëm, vendosjen e dritareve dy dhe tre-shtresore, si dhe izolimin e kulmit. Një përparësi thelbësore për zbatimin e masave të EE-së është se ekzekutimi i tyre është efektiv edhe në kohë, por edhe nuk ka procedura tejet të gjata të marrjes së lejes. Në Kosovë, një numër i madh i objekteve mbetet pa izolim, gjë që çon në shpenzime të mëdha të energjisë, duke e detyruar familjen kosovare të konsumojë katërfishin e energjisë që konsumon një mesatare evropiane në një vit.

Sipas Studimit të Bankës Botërore për Eficiencën e Energjisë në Kosovë, të vitit 2013, sektori banesor përfaqëson fondin më të madh të objekteve në Kosovë, ku përfshihen afro 70% të të gjitha ndërtesave në vend.⁶ Objektet banesore 34,72 milionë m² të sipërfaqes së përgjithshme të sektorit të ndërtimitarisë, që zë gjithsej 45,12 milionë m² në vend.⁷ Me marrjen e disa masave minore izoluese, ky paraqet edhe potencialin më të lartë për masat dhe dobi të eficiencës së energjisë, jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në atë mjedisor.⁸ Kjo nuk do të thotë që të gjitha ekonomitë familjare janë në të njëjtën gjendje të izolimit; disa familje kanë nevojë për më shumë intervenime, me shkallë më të lartë të kthimit në kursime të energjisë, si dhe nivele më të larta të rehatisë.

Duke shikuar sfondin e legjislacionit dhe strukturën institucionale në fund të vitit 2018, Kosova ndryshoi ligjin për eficiencë, ku “përveç transponimit të [Direktivës së Eficiencës së Energjisë], Ligji i ri për Eficiencën e Energjisë krijoi edhe bazën ligjore për krijimin e mekanizmit të parë financiar për eficiencën e energjisë, Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (këtu e tutje FKKEE, ose Fondi). FKKEE pritet të luajë rol të rëndësishëm në financimin e masave të eficiencës së energjisë në institucionet publike, si komunat dhe ministrinë”.⁹ Sipas ligjit, FKKEE-ja është organ i pavarur, përgjegjës për mbështetjen dhe zbatimin e masave dhe investimeve të eficiencës së energjisë në subjekte publike dhe private, sektorin e banimit dhe përfitues të tjerë të mundshëm. Fillimisht, FKKEE-ja siguroi mbështetje financiare nga Buxheti i Kosovës në vlerë prej 3 milion euro për secilin nga vitet fiskale të periudhës 2019-2021, 9.4 milionë euro nga Bashkimi Evropian në grante IPA, si dhe 6 milionë dollarë nga Banka Botërore që shteti do të kthejë, si kapital të zotuar për shpenzimet operative

⁶ Banka Botërore, Studimi Kombëtar i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesa në Kosovë, (2013), gjendet tek https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/Feature%20Story/ECA/kosovo/Kosovo%20Eptisa%20Final%20Report_2013.04.13.pdf (qasur në korrik të vitit 2020)

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Eficiencia e Energjisë në Kosovë, (2019), Raporti i Tretë Vjetor për Direktivën e Eficiencës së Energjisë, gjendet tek https://www.energy-community.org/dam/jcr:71043df6-8595-4e36-b292-90d9df716891/3rdEED_AR_KO_%20102019.pdf (qasur në korrik të vitit 2020)

të Fondit derisa të sigurohet statusi i tij i vetë-qëndrueshëm.¹⁰ Fondi aktualisht operon vetëm në sektorin publik, me fokus në ndërtesat komunale. Rreziku i përfshirjes së Fondit do të ishte mungesa e përvojës deri më tash në adresimin e projekteve të mëdha, që mund të dalin të jenë të shpërndara nëpër Kosovë. Përparësia kryesore është pavarësia e tij si institucion, që e bën skemën më pak të varur nga ndryshimet në qeveri. Fondi është alternativa më e qëndrueshme e zbatimit të cilësdo skeme që duhet të merret parasysh nga politikëbërësit, pasi ka tashmë bazën ligjore, por edhe prirjen drejt sigurimit të një mekanizmi të fortë financimi për masat e EE. Në dritën e aspiratës së Kosovës për t'u anëtarësuar në BE, ku ky i fundit së voni ka shpallur Marrëveshjen ambicioze të Gjellbër Evropiane, duhet të ketë reagim të ngjashëm edhe në Kosovë.

Ka mësimet e shumta e të dokumentuara që janë nxjerrë nga qasje të tilla, ndërsa një publikim i mirë i përgatitur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe BERZH-i është: “Mekanizmat e centralizuar të financimit të eficiencës së energjisë: Udhëzime për politika”, i cili mund të shërbejë si pasqyrë e shembujve të burimeve të financimit, formave të mekanizmave, si dhe qasjes në ndarjen e fondeve më vendet e BE-së, por edhe një elaborim të përparësive dhe mangësive të tyre. Qeveria e Kosovës nuk ka ende ndonjë plan konkret në lidhje me financimin e tillë të masave të EE-së në sektorin privat dhe atë të banimit. Me zhvillimin e pandemisë COVID-19, mundësia e adresimit të këtyre dy sektorëve me një pilot-projekt nga FKEE-ja do të duhej marrë parasysh seriozisht.

Nëse alokimi i parë nga burimet publike do të shfrytëzonte deri në 50 përqind të investimit total të nevojshëm në sektorin e ekonomive familjare, ai duhet të fillojë së pari me ekonominë familjare, ashtu që të jetë skemë e thjeshtë që do të nxiste interesim të gjerë për masat e EE-së. Me të njëjtën monedhë, nëse qeveria financon deri në 10 milionë Euro në dy vite fiskale, ndërsa sektori privat pjesën e tij me 10 milionë apo më shumë, afro 20+ milionë do të investoheshin në masa të EE-së. Me informalitetin e madh në ekonomi, shënjestra do të ishte tek familjet me dy ose më shumë burime të të ardhurave, si dhe të cilat do të kishin paratë e investimit të përllogaritur për EE për të financuar pjesën tjetër me fonde publike. Për të stimuluar edhe më shumë përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale, kjo politikë do të mund të shënjestronte zonat e largëta, gjë që do t'i bënte zonat rurale më tërheqëse, duke zvogëluar kështu edhe problemin e mbipopullimit urban të kryeqytetit. Pasi që ekonomia në masë të madhe po orientohet kah shërbimet, ngritja e treguesve të cilësisë së jetesës, të cilët aktualisht po

¹⁰ Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2018), Ligji Nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë, Prishtinë, gjendet tek https://mzhe-ks.net/repository/docs/LAW_NO.06_L-079_ON_ENERGY_EFFICIENCY.PDF (qasur në korrik të vitit 2020)

adresohen nga projekte që synojnë të ofrojnë lidhje më të mirë të internetit për familjet rurale, do të fitojë në rëndësi.

Meqenëse Qeveria ka kapacitete të kufizuara për të siguruar e menaxhuar efektivisht skemën e tillë në nivel ministrie apo agjencie, ajo duhet të ngarkojë FKKE-në me zbatimin e një investimi të tillë, pasi Ligji i 2018 për Eficiencën e Energjisë identifikon Fondin si mekanizmin kryesor të specializuar të financimit për sektorin. Për më tepër, Ligji lejon modifikimin e instrumenteve të financimit bazuar në marrëveshjet me qeverinë, donatorët ose subjekte të tjera. Qeveria dhe Fondi duhet të dakordohen mbi një skemë që përcakton kriteret dhe shënjestron saktë investimet me kthimin më të lartë në eficiencë të energjisë. Përveç caktimit të një liste të kriterëve të qarta për aplikantët amvisnorë, 10 milionët e Qeverisë do të duhej të financonin edhe auditimin energjetik të objekteve, bashkërisht me ekonominë familjare, ashtu që të përforcohet edhe më gjerësisht prania e auditorëve të energjisë në sektorin e ndërtimitarisë. Nga njëra anë, zgjedhja e auditorit duhet të bëhet nga Fondi, pasi do të shmangte ekspozimin ndaj projekteve që nuk janë të realizueshme ose që nuk janë vlerësuar siç duhet. Nga ana tjetër, kontraktimi i punëkryesve për investime duhet të jetë zgjedhje e pronarit të shtëpisë. Edhe rregullimet midis Qeverisë dhe Fondit mund të dakordohen deri në mes të tetorit 2020, ndërsa njëkohësisht, kjo do të mund të kombinohej edhe me përpjekjet për futjen e 10 milionëve në buxhetin e vitit 2021, ku këstet i paguhen Fondit. Si me rastet e mëparshme, kur fondet e tjera publike, siç janë Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, janë financuar nga institucione financiare ndërkombëtare (IFN), edhe për këtë, një pjesë e financimit publik mund të vijë nga fondet e IFN-ve.

Energy Commodity	Residential Buildings			Public and Private Service			TOTAL
	Energy price €/kWh	Energy saving GWh	Energy saving value € m.	Energy price €/kWh	Energy saving GWh	Energy saving value € m.	Energy saving value € m.
Coal	0.0114	45.03	0.51	0.0126	36.27	0.45	0.97
Oil by-products	0.1251	188.89	23.64	0.1126	221.93	25.00	48.64
Fire wood	0.0307	587.28	18.03	0.0307	299.81	9.20	27.24
Electricity	0.0802	1142.0	91.63	0.1298	202.72	26.31	117.94
Heat	0.0542	34.12	1.85	0.0597	22.19	1.32	3.17
TOTAL			135.68			62.30	197.99

Tabela 1: Vlera monetare e kursimeve të energjisë (çmimet aktuale (2013))¹¹

¹¹ Banka Botërore, Studimi Kombëtar i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesa në Kosovë, (2013), gjendet tek https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/Feature%20Story/ECA/kosovo/Kosovo%20Eptisa%20Final%20Report_2013.04.13.pdf (qasur në korrik të vitit 2020)

Me çmimet e vitit 2013, tabela tregon se potenciali më i lartë për kursimin e energjisë me zbatimin e masave ishte në sektorin e banimit/ekonomive familjare, me 135.68 milionë euro, si dhe sektori privat dhe publik me 62.3 milionë. Studimi pohon më tej se "kursimet do të mbulonin koston e masave brenda 7 viteve",¹² ndërsa me sektorin e banimit që përdor energji elektrike për ngrohje në sezonin e dimrit, kur edhe energjia elektrike është më e shtrenjtë, mund të merret një periudhë edhe më e shkurtër e kthimit për masat e EE-së. Shembulli ynë përqendrohet vetëm në sektorin e banimit, ndërsa përpiqemi të bazojmë llogaritjen tonë në një shtëpi që ka parametrat e shumicës së shtëpive që gjenden aktualisht në Kosovë.

3. Analiza: Zbatimi i masave EE në sektorin e banimit

Si pasojë e politikave të pazbatuara urbane në të kaluarën, si dhe informatave të kufizuara për tipologjinë e objekteve banesore, Kosova është vendi i një numri të madh të shtëpive me karakteristika krejtësisht të ndryshme, veçanërisht në lidhje me konsumin e energjisë, shfrytëzimin e hapësirës, ndriçimin natyror, etj. Meqenëse rregullimet aktuale të nivelit kombëtar pritet të kalojnë ngadalë nga investimet në shkallë të gjerë në EE në objekte publike tek akomodimi i kërkesave për objekte të pavarura private, fokusi duhet të vihet tek ata përbërës që do të kualifikoheshin për financim sipas skemës së propozuar. Si pasojë, kostot e përafërta për shtëpi janë paraqitur më poshtë duke marrë parasysh tre pika të mundshme (dhe më thelbësore) të intervenimeve për eficiencë të energjisë në banim: izolimi, dritaret dhe kulmi.

4. Materialet & Kostot

1. Izolimi

Sa i përket izolimit të mureve të jashtme, ka një numër alternativash që një pronar i shtëpisë mund të zgjedhë, të cilat dallojnë sipas llojeve të materialeve të përdorura dhe kostove të tyre përkatëse. Dy opsionet e renditura më poshtë paraqesin llojet dhe praktikat më të shpeshta në Kosovë, ndërsa për sipërfaqen, merret supozimi i një madhësie mesatare të një shtëpie: 100m² dhe dy kate (më së shumti në total afro 8 metra lartësi).

¹² Po aty.

Opsioni 1: Izolimi me tulla fasade (mur tullash)

Izolimi me tulla fasade përbëhet nga shtresa të ndryshme mbi murin ekzistues (tulla argiile), përkatësisht: tjegulla saloniti (difuzive), izolimi termik (lesh guri), hapësirat ajrore dhe tulla. Shumica e këtyre materialeve prodhohen brenda vendit, me përjashtim të tullave. Tabela më poshtë ofron informacion të detajuar mbi vendin e origjinës, dimensionet dhe çmimet, mes tjerash.

Shtresa	Vendi i prodhimit	Dimensionet	Sipërfaqja	Çmimi/m ²	ÇMIMI TOTAL
Izolimi termik (lesh guri)	Kosovë	100mm	282m ²¹³ P+K1 (122m ² + 160m ²)	6€	1,629€
Çati me shtresa saloniti (difuzive)	Kosovë	/	282m ² P+K1 (122m ² + 160m ²)	1€	282€
Tulla	Rajoni/BE	120mm	282m ² P+K1 (122m ² + 160m ²)	30 € (rajonale) 60 € (tulla belge)	8,460€ ose 16,920€
Totali pas TVSH-së				37€ ose 67€	10,434€ ose 18,894€
Totali para TVSH-së					8,842.37€ ose 16,011.86€

Tabela 2: Izolimi me tulla fasade¹⁴

Opsioni 2: Izolimi me llaç

¹³ Sipërfaqja totale në metra katror pasqyron supozimin e një shtëpie 10x10m², përveç shtresave të paraqitura në Tabelën 1, përfshirë katin përdhësë dhe katin e parë.

¹⁴ Gjinnolli, Ervin, (2020), Arkitekt, Intervistë Personale

Për dallim nga fasada si më lart, kjo përdor shkumën EPS (polistiren i ekspanduar) për izolim termik, pastaj vendoset ngjitësi, rrjetë me lesh qelqi, ngjitës dhe fasadë silikate, në këtë renditje. Kjo alternativë është më e përballeshme dhe ajo që mbizotëron në Kosovë, e për të jepen informacione më të hollësishme në Tabelën 3.

Shtresat	Vendi i prodhimit	Dimensionet	Sipërfaqja	Çmimi/m ²	Gjithsej
Izolimi termik (shkumë EPS)	Kosovë	150mm	282m ² gjithsej P+K1 (122m ² +160m ²)	4€	1,128€
Llaç	Kosovë	2 -3mm	282m ² gjithsej P+K1 (122m ² +160m ²)	10€ (bashkë me rrjetën me fije qelqi dhe shtresën ngjitëse)	2,820€
Totali pas TVSH-së				14€	3,948€
Totali para TVSH-së					3,345.76€

Tabela 3: *Izolimi me fasadë silikate*¹⁵

2. Dritaret

Duke marrë parasysh faktin se dritaret mund të jenë ato që humbin deri në 30% të nxehtësisë apo energjisë së ajrit të kondicionuar në shtëpi, dritaret cilësore dhe të instaluar mirë luajnë rol të madh në ruajtjen e energjisë dhe eficientë e saj.¹⁶ Është me rëndësi kritike që korniza e dritares të mos

¹⁵ Po aty.

¹⁶Fisette, Paul (2003), Windows (Dritaret): Understanding Energy Efficient Performance (Të kuptojmë performancën e eficientë së energjisë, Universiteti Massachusetts Amherst, gjendet tek <https://bct.eco.umass.edu/publications/articles/windows-understanding-energy-efficient-performance/> (qasur në korrik të vitit 2020)

shkaktojë ura termike, ndërsa rekomandohet që të njëjtat korniza të jenë nga druri.¹⁷ Dritaret më eficiente në tregun kosovar, të prodhuara në vend, janë ato me dy ose tre shtresa qelqi, me çmim prej 100 - 120 EUR për m².¹⁸

Meqenëse madhësia dhe numri i dritareve dallojnë dukshëm nga shtëpia në shtëpi, një bazë për llogaritjet në Tabelën 4 janë supozimet që kanë për qëllim vetëm të orientojnë pronarin e shtëpisë për çmimet mesatare.

Dritaret	Trashësia	Dimensionet	Sasia	Çmimi/m ²	Gjithsej
Dritare e vogël e banjës	Xhama dyshtresore	600mm x 600mm (0.36 m ²)	1	100€	36€
Dritare me një krah	Xhama dy ose trishtresore	1,5m ²	2	100€ ose 120€	300€ ose 360€
Dritare me dy krahë	Xhama dy ose trishtresore	2,25m ²	2	100€ ose 120€	450€ ose 540€
Totali pas TVSH-së					786€ ose 936€
Totali para TVSH-së					666,10€ ose 793,22€

Tabela 4: Dritaret

3. Izolimi i kulmit

Izolimi i kulmit është një nga masat më të shtrenjta për eficiencën e energjisë, e cila është ndoshta një nga arsyet pse çdo masë e shpallur nga qeveria duhet ta ketë atë si objektiv kryesor. Nga tri masat më

¹⁷ Kada, Zamire, (2020), Arkitekthe, Intervistë Personale

¹⁸ Po aty

të rëndësishme të EE, duhet të merret në konsideratë veçanërisht kjo, pasi izolimi i kulmit është i dobët në shumicën e ndërtesave.

Shtresa	Vendi i prodhimit	Dimensioni	Sipërfaqja	Çmimi/m ²	Gjithsej
Barriera e avujve	Kosovë	/	100m ²	0.5€	50€
Izolimi termik - XPS	Kosovë	180mm	100m ²	13€	1,300€
Folie PE	Kosovë	/	100m ²	0.5€	50€
Llaç çimentoje	Kosovë	50mm	100m ²	7€	700€
Panele OSB	Kosovë	22mm	370m ²	8€	2,960€
Çati me shtresa saloniti (difuzive)	Kosovë	/	370m ²	0.5€	185€
Tjegulla çatie	Shqipëri	/	370m ²	9€	3,330€
Totali pas TVSH-së				38.5€	8,575€
Totali para TVSH-së					7,266.95€

Tabela 5: *Izolimi i kulmit*¹⁹

¹⁹ Gjinolli, Ervin, (2020), Arkitekt, Intervistë Personale

5. Ndikimi i politikës në sektorin e banimit

Në varësi të numrit të përfituesve të kualifikuar dhe interesimit të tyre për skemën e mbështetjes, kjo analizë rekomandon që aplikimet të kufizohen vetëm në shtëpi që kanë hapësirë prej 100 metra katrorë apo më pak. Për shkak se kjo e fundit përfaqëson dimensionet mesatare të shtëpive në Kosovë, kriteri i tillë do të mundësonte që një pjesë më e madhe e sipërfaqes totale të hapësirave të banuara të mbulohej nga skema, ndërsa përfshin në të njëjtën kohë një numër më të madh të banorëve si përfitues. Një çështje tjetër që ngritet në zbatimin e masave në ndërtesat e banimit është tek rastet e hapësirave plotësuese jofunksionale, ose kur ka edhe dyqan poshtë shtëpisë, duke marrë parasysh se më shumë se 90 përqind e bizneseve janë mikro-biznese.

Nga 10 milionët që qeveria mund të fusë në skemë, 0.6-0.7 milionë do të shpenzoheshin për të mbuluar auditimet e energjisë si dhe planet ekzekutive, gjë që lë rreth 9.3 milionë për t'u alokuar në masat e EE në sektorin e banimit. Zbatimi i të tri masave në shtëpi me 100m² do të duhej të kushtonte afro 13,800 euro. Si rezultat, rreth 1350 shtëpi mund të përfitojnë nga kjo skemë. Varësisht nga lloji dhe madhësia së shtëpive, numri i përfituesve do të ishte më i madh ose më i vogël në përputhje me rrethanat. Sidoqoftë, kompleksiteti i kësaj llogaritjeje qëndron kryesisht tek fakti se nuk ka shumë informata lehtësisht të disponueshme për fondin e ndërtesave në Kosovë, për sa i përket sipërfaqes që zënë, datës së ndërtimit, datës së rinovimeve, etj. Në të njëjtën kohë, një numër faktorësh të tjerë luajnë një rol në identifikimin e përfituesve të mundshëm, të tilla si numri i familjeve në ndërtesë, probleme të pronësisë së paqartë, etj.

5.1. Efektet e tjera që politika e re do të kishte në të ardhurat tatimore

Sipas Doganës të Kosovës, materiali ndërtimor që importohet nga vendet e CEFTA-s²⁰ (vendet fqinje, Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia), si dhe përmes Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE dhe Turqinë, i nënshtrohen vetëm normës prej 18% të TVSH (Tatimi mbi Vlerën e Shtuar), ndërsa importet nga vendet e tjera ngarkohen me taksë doganore prej 10%, përveç TVSH-së me 18%.²¹ Shumica e materialeve të përdorura për izolimin e mureve të jashtme, çatisë dhe dritaret prodhohen

²⁰ Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore

²¹ Dogana e Kosovës, (2016), Si importohen mallrat, Prishtinë: Dogana, gjendet tek <https://dogana.rks-gov.net/si-importohen-mallrat/> (qasur në korrik të vitit 2020)

në Kosovë, me përjashtim të tjegullave të kulmit dhe tullave. Këto të fundit paraqesin gjithashtu disa nga materialet më të shtrenjta nga shtresat e renditura më sipër, përkatësisht me afërsisht 10 EUR/m² dhe 30-60 EUR/m².

Nëse pronari i shtëpisë zgjedh izolimin e fasadës me tulla, me tulla të importuara nga Serbia, totali do të jetë 8,822 Euro. 18% e totalit mbahet në burim gjatë importit, duke gjeneruar kështu të ardhura prej 1,591.63 Euro për Qeverinë, për një shtëpi të Kosovës me madhësi mesatare. Megjithëse tullat jashtë zonës së CEFTA-s janë më të shtrenjta, por janë gjerësisht të disponueshme në treg, këto kushtojnë afërsisht 16,011.86 Euro për shtëpi, me një tarifë prej 2,882.14 Euro TVSH. Ndërsa kostoja totale për izolimin e jashtëm me llaç qëndron tek 3,948 Euro, TVSH-ja do të jetë 602,24 Euro.

Ngjashëm, të njëjtat rregullime vlejnë edhe për tjegullat e kulmit të importuara nga rajoni, përkatësisht nga Shqipëria, ku totali për një shtëpi do të ishte 7,665,25 Euro, me TVSH-në prej 1,379,75 Euro. Sa i përket dritareve, çmimi i tyre dallon nga njëri prodhues tek tjetri, ndërsa kjo varet kryesisht nga numri i shtresave të xhamit brenda kornizës së dritares. Për dritaret me dy shtresa, qofshin ato me një apo dy krahë, totali është 666.10 Euro (me dy shtresa) dhe 793.22 Euro (me tri shtresa), me TVSH 119.90 Euro, përkatësisht 142.78.

Çdo investim shtesë që do të plotësonte masat themelore të EE do të gjeneronte edhe më shumë të ardhura për sektorin publik. Është shumë e mundshme që një politikë e re me financim të drejtpërdrejtë publik nga buxheti i shtetit të rrisë vetëdijen dhe të rrisë investimet totale në sektor, me ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat e Qeverisë.

5.2. Fuqia punëtore dhe tatimi në të ardhura personale

Natyrshëm, secili prej skenarëve ose të gjithë së bashku kërkojnë fuqi punëtore të mjaftueshme për të mbajtur aktiv sektorin e ndërtimitarisë, në një kohë kur aktivitetet ekonomike do të përballen me sfida të një ekonomie post-pandemike.

Edhe pse kryesisht i pa raportuar, sektori i ndërtimitarisë është një nga punëdhënësit kryesorë në vend, me kapacitet të madh për ndikim ekonomik. Sipas Ligjit të Kosovës Nr. 03/L-212 për Punën, fuqia punëtore e kontraktuar duhet t'i raportohet Administratës Tatimore të Kosovës dhe Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK/Trusti), ndër të tjera, për qëllime tatimore, kontribute

pensionit dhe kërkesa të tjera ligjore.²² Është e rëndësishme të theksohet se kostot për secilën masë të EE më sipër reflektojnë edhe koston e punës në të, kështu që nuk ka kosto shtesë. Megjithatë si referencë, punëtorët paguhen mesatarisht 300 EUR në total për ndërtesë, ndërsa mbikëqyrësi merr pagë prej rreth 600 EUR në total.²³ Nëse raportohen tek njësitë e sipërpërmendura, këta punonjës dhe punëdhënësi duhet të paguajnë 5% të të ardhurave të tyre bruto për TKPK për kontributet e pensionit, dhe rreth 8% si tatim mbi të ardhurat personale.^{24,25} Kjo skemë mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në formalizimin e sektorit të ndërtimit.

²² Kuvendi i Republikës së Kosovës, (2010), Ligji Nr. 03/L-212 për Punën, Prishtinë, gjendet tek <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735> (qasur në korrik të vitit 2020)

²³ Kada, Zamire, (2020), Arkitekte, Intervistë Personale

²⁴ Administrata Tatimore e Kosovës, Informata të Përgjithshme për tatimet në Kosovë, Prishtinë: ATK, gjendet tek <http://www.atk-ks.org/en/portfolio/informata-te-pergjithshme-per-tatimet-ne-kosove/> (qasur në korrik të vitit 2020)

²⁵ Shënim: kjo bazohet tek supozimi se të punësuarit marrin pagë mujore brenda kufijve prej 250-450 EUR.

6. Kursimet e energjisë

Në lidhje me kursimet e energjisë, varen nga lloji i burimit të energjisë që përdor familja. Ato që përdorin energjinë elektrike për ngrohje, ftohje dhe ndriçim, do të kenë më së shumti kursime, pasi shtë njëri nga llojet më të shtrenjta të energjisë në dispozicion në Kosovë. Një faktor tjetër kryesor që




Figura 1 dhe 2: (1) Kërkesa specifike për energji aktuale, bazë dhe efiçiente për të gjitha kategoritë e ndërtesave të banimit (kWh/m² vit). (2) Kursimi i energjisë ("EE aktuale" dhe plotësimi i nivelit të komoditetit) dhe kursimi ("BL-EE" dhe plotësimi i nivelit të komoditetit) për të gjitha kategoritë e ndërtesave të banimit (%)

do të ndikojë tek kursimet është teknologjia që përdoret për ngrohjen e hapësirave në amvisni pas zbatimit të masave të EE. Qeveria dhe Fondi mund të shënjestrojnë edhe shtëpi që kanë potencial më të lartë për kthim investimi nga masat EE, të tilla si njësitë banesore të ndërtuara para viteve 1980 ose shtëpitë njëkatëshe. Siç shihet në figurat 1 dhe 2 më lart, potenciali më i lartë i kthimit është në shtëpi një-katëshe, krahasuar me vilat, që zakonisht kanë izolim të mirë, si dhe ndërtesat e ndërtuara para luftës.²⁶

²⁶ Banka Botërore, Studimi Kombëtar i Efiçencës së Energjisë në Ndërtesa në Kosovë, (2013), gjendet tek https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/Feature%20Story/ECA/kosovo/Kosovo%20Eptisa%20Final%20Report_2013.04.13.pdf (qasur në korrik të vitit 2020)

Pjesa e energjisë në sektorin e banimit që shkon për ngrohje është rreth 70 për qind. Nëse masat EE do të bëheshin vetëm në ngrohje, kursimet do të ishin mesatarisht 46.1 për qind. Një e treta e energjisë së konsumuar aktualisht do të kursehej nëse këta 10 milionë do të financonin vetëm izolimin termik. Ndërrimi i pajisjeve për ngrohjen e ujit ose përdorimi i sistemeve diellore të ngrohjes së ujit, së bashku me zëvendësimin e poçave, këto do të rrisnin edhe më shumë kursimet totale të energjisë, me më shumë se 40 për qind të energjisë aktuale që konsumohet nga sektori i banimit.

7. Përfundim

Zbatimi i masave të reja në sektorin e ekonomive familjare dhe atë privat do të sinjalizojë ndryshimin për qytetarët e Kosovës, si dhe një vullnet për të filluar procesin që do të duhej të imitonte Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane. Një fakt që nuk duhet të injorohet është domosdoshmëria për t'i komunikuar popullatës rëndësinë e masave të EE-së në lidhje me faturat e tyre të energjisë elektrike, kursimet e energjisë dhe ndikimet mjedisore, ashtu që të arrihet tek një numër më i madh i përfituesve. Kjo skemë, me kontributin fillestar, do të ishte në gjendje të adresonte financimin e 1 për qind të investimit që nevojitet në sektorin e banimit.

Me uljen e fondeve për sektorin e transportit, do të ishte më mirë të përqendroheshin burimet publike në sektorin e energjisë pasi do të ishte si parakusht i investimeve që do të duhej të pasonin në sektorin e mjedisit. Për këtë qëllim, FKKEE-ja tashmë mbështet integrimin e teknologjisë së energjisë së ripërtërishme përmes ligjit për themelimin e tij, e kjo është një pjesë e sektorit me potencial të madh nëse shfrytëzohet sa më herët që është e mundur. Një sipërmarrje e tillë do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e ajrit në vend, si dhe do të luante një rol të madh në dekarbonizimin e ekonomisë që varet shumë nga lëndët djegëse fosile, pasi mund të përsëritet në biznese si dhe ndërtesat publike. Për më tepër, iniciativa si këto do të siguronin po ashtu më lehtë mbështetje, si dhe do të mbështeteshin nga institucione të tjera financiare (ndërkombëtare). Për më tepër, për të përmirësuar më tej EE-në në të gjithë sektorët, etiketimi i ndërtesave për energjinë e tyre do të lehtësonte identifikimin e ndërtesave që kërkojnë masa ndryshe nga ato në vend, si dhe që kanë potencial më të madh për kursimin e energjisë. Së fundmi dhe njëkohësisht, zgjerimi i ngrohjes qendrore tashmë është duke u zhvilluar, si dhe nëse shoqërohet me masat e EE-së, kursimet e energjisë do të ishin prapë më të larta, veçanërisht

në drejtim të shfrytëzimit të energjisë elektrike, ndërsa varësia nga drutë e zjarrit dhe qymyri (nga linjiti) do të ulet po ashtu në masë të madhe.

8. Rekomandimet

Zbatimi i një politike solide të efijencës së energjisë gjatë dy viteve do të ishte skema e parë e madhe e granteve që do të zbatohet me mbështetjen e burimeve publike, e që do të fillonte transformimin e sektorit të energjisë në Kosovë. Mënyrat e reja të financimit të efijencës së energjisë duhet të kenë parasysh nevojat e mëdha të sektorit dhe duhet të synojnë me kujdes një segment specifik jashtë ndërtesave publike, ashtu që të zbatohen në mënyrë efektive. Është koha e duhur për të filluar adresimin e energjisë për shkak të efekteve pozitive në mjedis, i cili është përkeqësuar me shpejtësi në gjysmën e shekullit të fundit.

Rekomandimi kryesor është që të përfshihen grante më të mëdha të siguruara fillimisht nga tatimpaguesit, e që më vonë do të zvogëloheshin në përputhje me rrethanat, me rritjen e interesimit dhe apetitit të ekonomive familjare dhe sektorit privat për të investuar në efijencën e energjisë. Deri në 20 përqind të investimeve totale do të ktheheshin në të ardhura të shtetit, ndërsa politika do të kishte ndikim në formalizimin e mëtejshëm të sektorit të ndërtimit. Në një skemë të ndarë saktësisht në 50-50 përqind, për çdo euro që Qeveria do të investonte në masat e EE-së do të sillte rreth 30 cent kthim në të ardhura, në përputhje me legjislacionin aktual të taksave. E rëndësishme është të theksohet fakti që çmimet do të dallojnë nga ndërtesa në ndërtesë, ashtu si edhe ofertat në treg gjatë fazës së zbatimit, kryesisht duke anuar kah ulja e kostove, krahasuar me ato që janë pasqyruar në këtë punim.

Informatat e dhëna më sipër paraqesin një numër opsionesh ndaj të cilave mund të ekspozohet një pronar shtëpie, që dallojnë kryesisht nga llojet e materialeve dhe kostot e tyre përkatëse, por secili shërben për të njëjtin qëllim, ekonomi familjare me efijencë të energjisë. Për të bërë të mundur që skema të arrijë sa më shumë familje, është propozuar që të zgjedhen materiale më pak të kushtueshme në rastet kur ka dy ose më shumë alternativa në dispozicion. Nga skenarët e ndryshëm të mundshëm të shtjelluar më lart, ky dokument politik propozon zgjedhjen e dritareve dy-shtresore, fasadën me llaç, me material izolues të prodhuar në vend, në vend të tullave të importuara nga rajoni dhe BE-ja, si dhe kulme me tjegulla çatie të importuara nga Shqipëria fqinje. Tabela më poshtë përshkruan këtë rekomandim në lidhje me kostot, duke mbuluar pjesët e paparashikueshme dhe tatimet e zbatueshme.

Masa EE	Çmimi/m2	Çmimi/shtëpi 2-katëshe 100m2	TVSH (18%)	Totali pas TVSH-së
Izolimi i mureve të jashtme	14	3,345.76	602.24	3,948
Dritaret	100	666.10	119.90	786
Izolimi i kulmit	38.5	7,266.95	1,308.05	8,575
Nën-total		11,278.81	2,030.19	13,309
Të paparashikueshme (rezervë)				532.36
Gjithsej				13,841.36

Tabela 6: Izolimi i llaçit, dritaret me dy krabë dhe kulmi (tjegulla të importuara nga Shqipëria)

Duke vazhduar me këtë rekomandim, skema mund të mbulojë potencialisht afro 1394 shtëpi (përdhesë dhe një kat) me madhësi mesatare prej 100m², ndërsa afro 2.83 milionë euro do t'i ktheheshin shtetit si të ardhura përmes mbledhjes së TVSH-së. Siç është elaboruar më lart, kostot për secilën masë përfshijnë edhe fuqinë punëtore; megjithatë, me formalizimin e sektorit, tatimet për punëtorin dhe punëdhënësin kthehen gjithashtu në shtet. Në investime më pak të favorshme në shtëpi me kursime të energjisë prej 1000 euro në vit, pronari i shtëpisë do të jetë në gjendje të ketë kthim të investimit brenda 7 viteve për 50% të investimit total të paguar nga klienti, që kërkohet për të aplikuar për masat e EE-së të përmendura më sipër.



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

This document was drafted as part of the project "Promoting Energy Efficiency and Renewable Sources in Kosovo" supported by the German Government through Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Kosovo Energy Efficiency Project. The views of the author of this document as well as the published data do not necessarily reflect the views of GIZ.